



REPUBLICA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine
Sektor i Arkivës-Sektor Archives

Shënim Org.
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i fletëve:
Br. Stranica
No. pages

Nr. Prot.
Broj Prot.
Prot. No.
Data:
Datum:
Date

157
17.05.12

Prokuror: Prokuror

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine. – Ministry of Labour and Social Welfare.

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

e lidhur në mes:

1. Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

dhe

2. Komunës së DEQANIT

I. Hyrje

Duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë në Republikën e Kosovës, nevojën për krijimin e vendeve të punës në planin afatshkurtër, zhvillimi i programeve të punëve publike është zgjedhur si një prej masave të rëndësishme në realizimin e politikave të përcaktuara në **Strategjinë e Punësimit (2010 – 2012)** e hartuar nga **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)**. Duke marrë parasysh nivelin e ultë të zhvillimit ekonomik në Kosovës, gjenerimi i punësimit përmes programeve të punëve publike mund të jetë i një rëndësie të veçantë për ngritjen e shkallës së punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E DEQANIT - DEÇAN DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY

Mqa:
Od:
From:

Nr. i fletëve:
Br. Stranica:
No. Pages:

Mr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No.

2135
02
21.5.12

DEÇAN DEÇANE

Për këtë qëllim, MPMS do të lidhë Marrëveshje të Mirëkuptimit, me Komunë, e cila i ka plotësuar kushtet e specifikuara në Manual për realizimin e Projektit.

II. Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është realizimi i Strategjisë së Punësimit përmes Programit; „**Punë Publike Kosova/2012,**”

III. Objekti i Marrëveshjes

Objektiv i kësaj Marrëveshjeje është të realizojë projektin me titull:

1. UJESJELLESI PËR FSHATIN STRELLC I EPËRM DHE STRELLC I ULTË
me vlerë 139,870.00 €

IV. Obligimet e MPMS-së

- MPMS do të bëjë zotimet e mjeteve financiare në shumën përfituese të Komunës për realizimin e projektit dhe do të bëjë pagesën në tre faza në bazë të progresit të arritur në realizimin e projektit dhe sipas raporteve të dorëzuara nga Zyra e Prokurimit të Komunës në MPMS. Dy faza të para do të jetë nga 30 % të vlerës së kontratës ndërsa pagëesa përfundimtare do të jetë 40% të vlerës së kontratës. Komunitat do ta kenë një kopje të zotimit të mjeteve financiare, në mënyrë që të vazhdojnë me procedurat e Prokurimit dhe nënshkrimin e Kontratës me kompaninë përfituese të projektit.
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale do të publikojë konkurse për ata punëtorë që do të angazhohen përmes Zyrës së Punësimit dhe do të i ofrojë kompanisë përfituese të realizimit të projektit përmes komunsës listën e punëtorëve për përzgjedhjen e tyre sipas kriterëve të përcaktuar në manual(doracak).
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e mban të drejtën për të mbikëqyrë Komunitën dhe kontraktuesin lidhur me realizimin e obligimeve të marrura në lidhje me punësimin e të papunëve.
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale monitoron përfshirjen e kriterëve kyq në dosjen e tenderit dhe kohë pas kohe mbikëqyrë realizimin e projektit.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale nuk mbanë përgjegjësi për mbulimin e shpenzimeve shtesë.

V.- Obligimet e Komunës

- Do të zbatojë projektin në pajtim me Programin dhe marrëveshjen.
- Inicojë procedurat për përzgjedhjen e kontraktuesit për implementimin e projektit.
- Do të bëjë mbikëqyrjen e punimeve dhe monitorimi teknik i vend-punimeve (nga organi mbikqyrës).
- **Që në dosjen e tenderit dhe në kontratë të përfshinë këto kushte:**
 - a) që projekti të përfundojë deri më 30.11.2012;
 - b) që projektet sipas Kategorisë B ,40% të shpenzimeve nga projekti të jenë të dedikuara për pagat e të punësuarve;
 - c) Kontraktuesi është i obliguar të punësojë së paku 47 punëtorë për zbatimin e këtij projekti;
 - d) Nga numri gjithësej të punëtorëve të specifikuar më lartë së paku 50% e tyre të angazhohen përmes Zyrave të Punësimit;
 - e) kohëzgjatja e të punësuarve duhet të jetë 4 muaj;
- Që të bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar se projekti i arrinë efektet e punësimit të specifikuar në propozim. Nëse komuna parasheh se këto efekte nuk do të plotësohen, atëherë ata duhet menjëherë të informojnë me shkrim Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me këtë dhe të japin arsyet për shmangiet e pritura.
- Komuna është e obliguar që para se të shpallë tenderin t'i dorëzojë një kopje të dosjes së tenderimit të prokurimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Mjetet e parapara për financimin e projektit të aprovuar nga MPMS-ja duhet të përdoren vetëm për këtë qëllim.
- Komuna duhet t'i dorëzojë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale raportet mujore të progresit mbi dinamikën e realizimit të projektit duke përdorur shabllonin e raportimit bashkangjitur si Anex F në Manualin e Programit dhe dokumentacionin përkatës për procesim të pagesës nga MPMS-ja.
- Komuna duhet të sigurojë që në **Komisionin e Pranimit Teknik** të punëve të jetë një anëtarë nga MPMS-ja.

VI - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët duhet të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre eventuale në frymën e vullnetit të mirë dhe të negociatave miqësore. Cilido konflikt i cili buron nga interpretimi i kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë edhe përmbajtjen e saj, validitetin ose përfundimin, duhet të zgjidhet para gjykatës kompetente.

VII – Përfundimi


Ministria e Punës dhe Mirëqenje Sociale do të mbajë të drejtën për të anuluar Marrveshjen e Mirëkuptimit me Komunën përkatëse në rast të mos zbatimit të kësaj marrëveshjeje sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në MM.

VIII - Kohëzgjatja

Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të mbetet valid derisa palët të kenë përmbushur të gjitha obligimet e tyre sipas Memorandumit.

IX- Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga ana e të dy palëve.



Nenad RASIC

Ministër i MPMS-së



Rasim SELMANAJ

Kryetari i Komunës

Prishtinë, maj 2012